

SPECIFIKIME-TEKNIKE

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Tiranë 2025



FOCUS ARCHITECTURE
adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

1. SEKSIONI - SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Të përgjithshme.
 - 1.1.1 Shpjegim i terminologjisë.
 - 1.1.2 Qëllimi i punës.
- 1.2 Dorëzimet të mbikqyrësi i punimeve.
 - 1.2.1 Njësitë matëse.
 - 1.2.2 Grafiku i punimeve.
 - 1.2.3 Autorizimet me shkrim.
 - 1.2.4 Informacioni që duhet të sigurohet mbikqyrësit të punimeve restauruese.
 - 1.2.5 Dorëzimet.
 - 1.2.6 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç janë zbatuar).
 - 1.2.7 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave.
 - 1.2.8 Dokumentat dhe vizatimet.
 - 1.2.9 Mostrat.
 - 1.2.10 Zëvendësimet.
 - 1.2.11 Fotografitë e objektit para - pas punimeve restauruese.
- 1.3 Punime të gabuara dhe siguria.
 - 1.3.1 Siguria në punë.
 - 1.3.2 Punime të gabuara.
 - 1.3.3 Punime të rrezikshme.
 - 1.3.4 Tabelat njoftuese, etj:.
 - 1.3.5 Sigurimi teknik.
- 1.4 Gërmimet.
- 1.5 Hedhja dhe emërtimi i materialeve.
- 1.6 Mbrojtja.
 - 1.6.1 Puna ekzistuese.
 - 1.6.2 Zbritja e materialeve.
 - 1.6.3 Dëmtimet gjatë dimrit.
 - 1.6.4 Mbrojtja e punës dhe e publikut.
 - 1.6.5 Mbrojtja e pemëve.
- 1.7 Skleria.
- 1.8 Supervizioni
- 1.9 Transporti dhe magazinimi i materialeve.
- 1.10 Pastrimi i kantierit.

2. SEKSIONI - PUNIME PRISHJE/ ÇMONTIMI DHE SISTEMIM TERRITORI

- 2.1 Të përgjithshme.
- 2.2 Punime prishjeje.
 - 2.2.1 Skarifikimi.
 - 2.2.2 Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.
 - 2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar.
- 2.3 Mbikqyrja.
 - 2.3.1 Metoda e prishjes.
 - 2.3.2 Çmontim i tubacioneve ekzistuese të ujërave të zeza që dalin në fasadë si dhe ulluqet vertikale.
 - 2.3.3 Prishje mur guri.
 - 2.3.4 Prishje mur tulle.
 - 2.3.5 Prishje suvatimi.
 - 2.3.6 Heqja e veshjes me pllaka të mureve.



- 2.3.7 Heqje e kangjellave metalike.
- 2.3.8 Heqje e dyer-dritare.
- 2.3.9 Zbërthimi i cative.
- 2.4 Punime dheu dhe sistemim territori.
 - 2.4.1 Përpunimi i pjerrësisë.
 - 2.4.2 Mbrojtja e punimeve të dheut dhe ndërtim i drenazhit.
 - 2.4.3 Pastrim nga bimësia e ulët + injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija në muraturë.
 - 2.4.4 Transport materiale ndërtimi, mbeturina dhe dheu.
 - 2.4.5 Mbjellja dhe plehërimi.
 - 2.4.6 Bimësia e përdorur.
 - 2.4.7 Mobilimi urban.

3. SEKSIONI - NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

- 3.1 Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.
 - 3.1.1 Restaurimi i cative.
 - 3.1.2 Pastrim i mureve në fasadë nga pluhurat dhe depozitimet sipërfaqësore me furçë dhe larje me ujë.
 - 3.1.3 Restaurim mur guri llaç gëlqere 1:3.
 - 3.1.4 Suvatim i jashtëm.
 - 3.1.5 Lyerje e fasadave me bojë hidroplastike.
 - 3.1.6 Veshje e fasadave me sistem kapot.
 - 3.1.7 Vendosja e ullqeve vertikale dhe horizontale.
 - 3.1.8 Lyerje me bojë vaji e sipërfaqeve metalike.
 - 3.1.9 Lyerje e sipërfaqeve të drurit.
 - 3.1.10 Shkallë me beton të larë me aggregate.
 - 3.1.11 Korimanot metalike.
 - 3.1.12 Dritare, dyer/ Informacion i përgjithshëm/ Kërkesat.
 - 3.1.13 Vendosja e dritareve, grilave dhe dyerve të jashtme prej druri.
 - 3.1.14 Menteshat.
 - 3.1.15 Dorezat.
 - 3.1.16 Vendosja e portave të jashtme metalike.
 - 3.1.17 Vendosja e qepenave metalik të dyqaneve.
 - 3.1.18 Vendosja e elementeve metalike kornizuese për vendosjen e logos së dyqaneve.



1. SEKSIONI - SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Të përgjithshme.

1.1.1 Shpjegim i terminologjisë.

"Restaurim": është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.

1.1.2 Qëllimi i punës.

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë çdo defekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Materialet, pajisjet dhe të gjitha sende të tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve restauruese.

1.2 Dorëzimet të mbikqyrësi i punimeve.

1.2.1 Njësitë matëse.

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Ton (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si ".".

1.2.2 Grafiku i punimeve.

Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë mbikqyrësit të punimeve restauruese një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në objekt deri në mbarim të punës.

1.2.3 Autorizimet me shkrim.

"Rregullat me shkrim" do t'i referohen çdo dokumenti të nënshkruar nga Mbikqyrësi i Punimeve restauruese të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate. Fjalët e miratuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktura, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që miratimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.



1.2.4 Informacioni që duhet ti sigurohet mbikqyrësit të punimeve restauruese.

Vizatime grafike që tregojnë sistemimin e përgjithshëm të ambientit dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes së konstruksioneve dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për konsolidim e restaurim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe pajisje e makineri që do të përdori. Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të zbatuar këto punime është temë për t'u rregulluar dhe miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve të restaurimit, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

1.2.5 Dorëzimet.

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Mbikqyrësit të punimeve restauruese: për çdo punim shtesë një vizatim të detajuar dhe volumin e kërkuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas miratimit nga Mbikqyrësi i punimeve. Në rast se punimet shtesë janë zëra të rinj dhe prekin thelbin e projektit të restaurimit, punimet duhet të miratohen fillimisht nga mbikqyrësi i punimeve dhe Zhvilluesi (investitori). Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkojnë nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi i Punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësin e Punimeve dhe duke iu referuar programit të miratuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësit për të bërë këto pranime.

1.2.6 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç janë zbatuar).

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet "siç janë zbatuar faktikisht" në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimeve siç është zbatuar". Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikqyrësit të punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër. Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, "siç është zbatuar" do t'i dorëzohen Mbikqyrësit për miratim.

1.2.7 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave.

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të miratuara nga Mbikqyrësi, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.



1.2.8 Dokumentat dhe vizatimet.

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasisë dhe detajet të treguara në Vizatimet Grafike, ose të dhëna të tjera dhe Zhvilluesi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Zhvilluesi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.2.9 Mostrat.

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkojnë me të drejtë nga Mbikqyrësi për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësit.

1.2.10 Zëvendësimet.

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me miratimin e Mbikqyrësit të Punimeve i cili duhet të jetë i argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në objekt në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

1.2.11 Fotografitë e objektit para - pas punimeve restauruese.

Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e objektit përpara fillimit, progresin gjatë punës restauruese dhe mbas përfundimit të punimeve.

1.3 Punime të gabuara dhe siguria.

1.3.1 Siguria në punë.

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë:

Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet.

Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë.

b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmëta, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

1.3.2 Punime të gabuara.

Çdo punë, që nuk është në përputhje me projektin e miratuar, si dhe këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit të miratuar. Në rastet kur kontraktori i punimeve restauruese gjykon të përshtasi punime gjatë procesit të restaurimit në funksion të këtij procesi, çdo ndryshim bëhet me miratim të Mbikqyrësit të Punimeve dhe këto përshtatje nuk duhet të prekin thelbin e projektit.



1.3.3 Punime të rrezikshme.

Magazinimi i bombolave të gazit me presion është e ndaluar. Gjatë punimeve të rrezikshme me gazrat e ndezshme duhet mbajtur fikëse zjarri të tipit mobile sipas DIN EN 2/3 duhet të jetë në dispozicion pranë vendit ku punohet.

Klasa A: Përdoret për zjarre që rezultojnë nga materiale të forta si psh.: Dru, letër, tekstile, plastike, etj.



Fig. 1.

Sasia e bombolave fikëse duhet të vendoset sipas kërkesave të normave/standardeve bashkëkohore dhe moderne (psh DIN EN 3). Ata duhet të mirëmbahen dhe të kontrollohen të paktën çdo dy vjet nga autoritetet e licensuara. Fikësit e zjarrit janë komponente aktive të mbrojtjes kundër zjarrit. Nuk duhet harruar edhe komponenti pasiv që në rastin tonë është përbërja drusore e elementeve të ndërtimit e cila nuk na favorizon në mbrojtjen kundër zjarrit.

1.3.4 Tabelat njoftuese, etj:.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.3.5 Sigurimi teknik.

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit teknik në punë. Ai duhet të sigurojë një plan për sigurimin teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit teknik, kryerjen e instruktimit teknik për çdo punonjës dhe për çdo zë pune specifik. Gjatë punimeve të prishjes e çmontimit punëtorët duhet të veshin rroba të dhura të sigurisë duke përfshirë syze në mbrojtjen e syrit, maska pluhuri, këpucë të sigurisë, doreza të punës dhe kasketa të forta, gjithashtu këto masa duhet ti sigurojnë edhe gjatë proceseve të tjera të punës. Kontraktori duhet të mbajë proces-verbaleve për çdo lloj aksidenti të mundshëm në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit teknik të cilin duhet t'ja prezantojë Mbikqyrësit çdo muaj.



1.4 Gërmimet.

Të tregohet kujdes gjatë gërmimit për ndërtimin e drenazhit, këto punime duhet të kryen me krahë dhe në prezencë të arkeologut monitorues.

1.5 Hedhja dhe emërtimi i materialeve.

Duke përjashtuar rastet ku tregohet në specifikime, në raste të tjera të gjitha materialet rikupero do të ripërdoren dhe materialet e papërshtatshme largohen nga kantieri dhe nuk ripërdoren. Titullimi për të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja - çmontimi, dhe pajisjeve që do të hiqen, i vishet Kontraktuesi me miratimin e Mbikqyrësit. Me autorizim nga Mbikqyrësi mund të fillojnë punimet për prishjen - çmontimin. Materialet dhe pajisjet rikupero të pronës nuk do të shiten nga Kontraktori, ato mund të ripërdoren sipas udhëzimeve të mbikqyrësit.

Materialet e tjera që nuk mund të ripërdoren dhe që konsiderohen si mbetje, do të largohen nga Kontraktori dhe do të depozitohen në vendet e caktuara nga Bashkia.

1.6 Mbrojtja.

1.6.1 Puna ekzistuese.

Pas fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojë dhe të identifikojë të gjitha njësitë ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b) për ripërdorim. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit.

Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore me depozitime materialesh. Duhet siguruar mbështetje të reja dhe përforcime për ndërtimet e dobësuara ekzistuese nga punimet e prishjeve-çmontimeve. Në asnjë moment për çfarëdolloj arsye nuk duhet të rrezikohet dëmtimi i strukturës së pasurisë kulturore. Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet (puntelime, përforcime, pajantime) dhe të izolojë zonën dhe të informojë Mbikqyrësin.

1.6.2 Zbritja e materialeve.

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar lëvizjet e materialeve, rënien në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës publike të çdo lloji.

1.6.3 Dëmtimet gjatë dimrit.

Punimet duhet të jetë të mbrojtura nga dëmet e mundshme që vijnë si pasojë e temperaturave të ulëta. Do ishte e preferuar që të evitohet puna në temperatura më të ulëta se 5°C, por në rast se do jetë e domosdoshme të vijojë puna pa ndërpreje të merren masa shtesë për të siguruar mikroklimë me temperatura të përshtatshme për punimet si fugatime, injektime, qepje konstruksioni apo punime të cilat ndikohen drejtpërsëdrejti nga temperaturat dhe ciklet ngrirje-shkrirje.

1.6.4 Mbrojtja e punës dhe e publikut.

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtësive dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

1.6.5 Mbrojtja e pemëve.

Të gjitha pemët të cilat nuk janë të aprovuara për prerjen duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë tërë periudhës së kontratës. Pemët me diametër më të vogël se 10 cm dhe të larta deri 1m mbi tokë (shkurret, barërat etj) do të priten, pa lejen paraprake autoriteteve dhe të mbikëqyrësit.

1.7 Skelëria.

Të gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet e përshtatshme për qëllimin për të cilin janë të dedikuara.

Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara janë rreptësisht të ndaluara. Duhet patur kujdes që ngarkesa e çdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë ngarkesën e lejuar sipas projektimit dhe të bëhet shpërndarje e tyre. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma. Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj. 15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës.



1.8 Supervizioni.

1.9 Transporti dhe magazinimi i materialeve.

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

1.10 Pastrimi i kantierit.

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet. Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera. Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

2. SEKSIONI - PUNIME PRISHJE/ ÇMONTIMI DHE SISTEMIM TERRITORI.

2.1 Të përgjithshme.

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm. Në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi teknik i punimeve restauruese. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. Materialet e nxjerra nga çmontimi pas seleksionimit nëse nuk janë të dëmtuar ripërdoren.

KËRKESAT; Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuar ose të specifikuar. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marr masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të mbetjeve.

2.2 Punime prishjeje.

2.2.1 Skarifikimi.

Largime të mëdha me ekskavatorë dhe skarifikime, të kryera me dorë ose makinë nga terrene, nga çfarëdo lloj toke, qoftë edhe e ngurtë (terrene të ngurtë, rërë, zhavori, shkëmborë) duke përfshirë lëvizjen e rrënjëve, trungjeve, shkëmbinjve dhe materialeve me përmasa që nuk kalojnë 0,30 m³, duke përfshirë mbrojtjen e strukturave të nëndheshme si kanalizime uji, naftë ose gazi etj. dhe duke përfshirë vendin e depozitimit të materialeve brenda në kantier ose largimin e tyre në rast nevojë.

2.2.2 Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse. Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji. Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatorë hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që pjesë të tyre të mos kenë kontakt me kablllo telefonik ose elektrik. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për lëvizjen e kablllove.



2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar.

Kontraktori duhet të ngrejë rrjete të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin ku do të kryhen punimet.

2.3 Mbikqyrja.

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe punimeve të çmontimit në kantier.

2.3.1 Metoda e prishjes.

Metodat e prishjes/ çmontimit të pjesshëm, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Kur prishja e elementeve të ndërtesës nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të strukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë. Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

2.3.2 Çmontim i tubacioneve ekzistuese të ujërave të zeza që dalin në fasadë si dhe ulluqet vertikale.

Përpara fillimit të punimeve të restaurimit, kryhen punimet e çmontimit të elementëve të tubacioneve të shkarkimit të ujërave të zeza që dalin në fasadë si dhe të ullukut vertikal në fasadën veriore të kishës së madhe.

Do të bëhet heqja e kujdesshme e tubacioneve pa dëmtuar më tej muraturën. Materialet tubacionet PVC të dëmtuara edhe si pasojë e agjentëve atmosferik do të largohen nga kantieri. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për çmontimin. Mbasi bëhen këto punime paraprake, në prezencë të kontraktorit, dhe mbikëqyrësit të punimeve mbahet një proces-verbal për elementët e dëmtuar që do të hidhet. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim-shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

2.3.3 Prishje mur guri.

Do të bëhet prishja e muraturave të degraduara. Shqepja e murit të gurit do të realizohet me qëllim rindërtimin të tij dhe vënien në funksion. Shqepja do të realizohet në të gjithë lartësinë e murit. Gjatë prishjes së murit do të tregohet kujdes për mos dëmtimin e materialit guror.

2.3.4 Prishje mur tulle.

Do të bëhet prishja e muraturave të degraduara. Shqepja e mureve prej tulle do të realizohet me qëllim të rindërtimit të tyre dhe vënien në funksion. Shqepja do të realizohet në të gjithë lartësinë e murit. Gjatë prishjes së murit do të tregohet kujdes për mos dëmtimin e materialit.



2.3.5 Prishje suvatimi.

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për prishjen e çdo lloj shtrese suvaje (suva tradicionale, llaç gëlqere, llaç çimento, llaç i përzierë, etj.) në çfarëdo lartësi dhe sipërfaqe murature (tulle, guri, betoni, etj.); që realizohet me çdo lloj mjeti.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim-shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Në rastet e monumenteve të kulturës procesi i prishjes së suvasë duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:
- Vlerësimi i hollësishëm i gjendjes së konservimit nga specialisti restaurator, evidentimi i kufirit midis zonave ku do të ruhet suvaja autentike dhe zonat ku do të priset (Ky përcaktim bëhet mekanikisht duke bërë goditje të lehta me spatul mbi sipërfaqen e suvasë. Në zonat ku suvaja ka krijuar xhepa dhe është shkëputur nga sipërfaqja e murit, goditjet kanë tingull të ndryshëm nga ato në zonat me suva të padegraduar).
- Heqjen e kujdesshme në mënyrë manuale të suvasë së degraduar.
- Pastrimin me furçë teli të sipërfaqes së muraturës së zhveshur nga suvaja. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për prishjen e suvatimit të dëmtuar tek hauzet. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

2.3.6 Heqja e veshjes me pllaka të mureve.

Prishje e veshjeve me pllaka dhe pastrimi i llaçit që ndodhet poshtë duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

2.3.7 Heqje e kangjellave metalike.

Heqja e zgarave të hekurit dhe sistemimin e materialit që rezulton, duke përfshirë përzgjedhjen e mundshme (të përcaktuar nga D.P.) dhe vënien mënjane në një vend të caktuar të kantierit.

2.3.8 Heqje e dyer-dritare.

Heqjen e tyre nga muratura të çdo lloji dritareje ose dere, të çdo madhësie e materiali, me çdo mjet që do të jetë i nevojshëm. Në monumentet e kulturës heqja e dritareve do të bëhet e kujdesshme në mënyrë që lënda autentike në gjendje të mirë të mund të ripërdoret.

- Kontrollin e gjendjes së lëndës drusore, nëse mund të ripërdoret ose jo (vetëm për objektet monument kulture)
 - Ruajtjen dhe magazinimin e lëndës që do të ripërdoren (vetëm për objektet monument kulture).
- Transportin dhe grumbullimin e tyre për në vendin e caktuar nga mbikqyrësi. Ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin.



2.3.9 Zbërthimi i çatisë.

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla të tipit "Romana" (Vendi) dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqet vertikale dhe kapëset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin dhe vënien mënjane të tjegullave që do të ripërdoren, si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar heqjen. Shpërbërja e çatisë me tjegulla druri ose llamarinë, me të njëjtat modalitete dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqet vertikale dhe kapëset përkatëse metalike, kullezat e oxhakut, duke përfshirë skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar heqjen. Heqja e tavanit të çfarëdo natyre, duke përfshirë strukturën mbajtëse, suvanë dhe impiantin elektrik që mund të ekzistojë; duke përfshirë ndër të tjera skelën, spostimin e materialeve që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit. Prishje e shtresës horizontale të hidroizolimit të tarracës me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, e ndërtuar nga tre shtresa të mbivendosura letër katramaje, duke përfshirë heqjen e kapakëve të parapetit e të çdo pjese metalike dhe vënien mënjane të 15 plotësisht heqjes së tarracës. Prishja e suvasë në sipërfaqet vertikale deri në një lartësi të paktën 30 cm, deri në dalje në dukje të muraturës, për vendosjen e guainës.

2.4 Punime dhe dhe sistemim territori.

2.4.1 Përpunimi i pjerrësisë.

Në rastet e terrenit me pjerrësi veprohet sipas tre mënyrave të mëposhtme:

- Nivelimi i pjerrësisë sipas pikës më të ulët të terrenit.
- Mbushja e terrenit me material ekstra, deri në nivelin e pikës më të lartë të terrenit.
- Gërmime dhe mbushje sipas pikës mesatare.
- Secila nga këto raste do të përdoret në varësi të llojit të dheut, të aftësisë mbajtëse të truallit dhe të ngarkesave të godinës që do të ndërtohet në atë truall.



2.4.2 Mbrojtja e punimeve të dheut dhe ndërtim i drenazhit.

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë përfshirë në zbatimin e projektit, nga ana tjetër duhet të mbrohet personeli që zbaton realizimin e projektit. Gjithashtu, duhet mbrojtur gropa/ kanali i hapur për drenazhin. Mbrojtja e njerëzve duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rrjetë gabiant etj.) i cili nuk i lejon ata (sidomos fëmijët) të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrethimit nga persona që ULTR nuk punojnë në projekt. Gropa/ kanalet dhe njerëzit që janë duke e punuar atë, duhen mbrojtur ndaj shembjes. Pjerrësia e ledhit e çdo grope duhet të jetë min. 45 gradë deri max. 60 grad.

Drenazhimi i ujërave të zeza do të bëhet përgjatë murit veri perëndimor dhe jug-perëndimor. Ky drenazhim përbëhet nga tubacione që dalin në nivelin e tokës nga muret përkatëse dhe nëpermjet tubacioneve Ø 15 PVC shkarkojnë në pusetat e shkarkimit 50x50x50 cm (ndërtuar me blloqe betoni lidhur me llaç), prej nga me anë të tubacioneve Ø200 betoni (të lidhura në seri) shkarkojnë në pusetën e madhe 80x80x150cm në qoshen perëndimore të manastirit. Nga puseta qëndrore me anë të tubacioneve Ø200 ujërat shkarkojnë në gropën ekzistuese septike (sipas detajit në grafikë).

2.4.3 Pastrim nga bimësia e ulët + injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija në muraturë.

Fillimisht do të bëhet pastrimi i vegjetacionit të ulët e të mesëm në muraturë.

Vegjetacioni i ulët do të pastrohet fillimisht mekanikisht, me prerje dhe shkulje dhe më pas do të injektohet herbicid për eliminimin e tij. Herbicidet kanë një gamë të gjerë, por në rastin tonë do zgjedhim herbicidin me bazë Glyphosate 36%.

Elementi më i rëndësishëm që ka ky lloj herbicidi është se ai degradohet shumë shpejt në terren dhe nuk akumulon mbetje të tij në territor duke patur një efekt mjedisor minimal. Ai nuk është i dëmshëm për insektet apo gjallesat e tjera tokëore, por është helmues për gjallesat ujore dhe si i tillë nuk përdoret për vegjetacionin ujor apo në afërsi të pellgjeve ujorë. Edhe pse efektet mjedisore janë minimale përdorimi i herbicidit do të bëhet vetëm në ato raste kur pastrimi mekanik (prerje/ shkulje) mund të dëmtojë strukturat.

Herbicidi para përdorimit hollohet me ujë në mënyrë që të thithet më lehtë nga bima.

O Përdorimi i herbicidit me përmbajtje Glyphosat-i 36% do të bëhet:

Në injektim në trung/ rrënjë të pemëve të larta dhe shkurreve raporti herbicid/ujë do të jetë 1:1.

Në spërkatje shumë të lokalizuar mbi shkurre dhe barishte relativisht të larta raporti herbicid/ujë do të jetë 1:3.

Në spërkatje të përgjithshme të barishteve në monumente raporti herbicid/ ujë do të jetë 1:60. Ndikimet e glifosatit janë të barabarta me ato të ujit mbi materiale si: dru, gurë, llaç me gëlqere, çimento, bojra afreske etj. Herbicidi me bazë glifosati bën pjesë në ato kimikate të cilat janë të licensuara për përdorim të përgjithshëm për trajtimin e barishteve.



Edhe pse herbicidi nuk ka përmbajtje kumulative, pra shpërbëhet brenda 72 orëve, gjithsesi ai është një kimikat dhe përdorimi i tij duhet të bëhet vetëm në hapësirat ku trajtimi mekanik është i pamundur.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin e muraturës nga bimësia e papërshtatshme dhe injektimin me herbicid. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

2.4.4 Transport materiale ndërtimi, mbeturina dhe dheu.

Pas punimeve të dherave, pastrimit të mbetjeve dhe materialeve dhe inerteve që dalin të papërdorshme ato do të largohen me transport me automjet. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për largimin e mbetjeve nga kantieri. Në çmim përfshihet transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia me auto deri në 10 km.

2.4.5 Mbjellja dhe plehërimi.

Kontraktori do të korrigjojë, me dhé bujqësor, vendet e mundshme të erozionit përpara mbjelljes; punimet e kontrollit të erozionit do të profilohen me të njëjtën pjerrësi si edhe skarpatat. Në veçanti është përshkruar që punimet e mbjelljes së bimeve kryen nga Kontraktori në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë terrenin, duke ruajtur pjerrësinë e skarpatës dhe duke menjanuar ndryshim që mund të jetë shkaktuar edhe nga ecja e punëtorëve. Përpara realizimit të ndonjë mbjelljeje, Kontraktori duhet të hapi gropën dhe të përgatisë dheun.

Në lidhje me mbjelljen e pemëve ose të bimëve, Kontraktori është i lirë të kryejë këto punime në çdo periudhë, brenda periudhës së punës së parashikuar për përfundim, që ai e konsideron më të përshtatshme për mbirje me zëvendësimin e bimëve të reja të cilat nuk arriten të nxjerrin rrënjë, duke qenë kjo nën përgjegjësinë e tij.

2.4.6 Shtrimet e shesheve.

Sheshet propozohen të shtohen me **beton te lare me agregate ne dukje dhe beton te lare me agregate ne dukje te pigmentuar**. Betoni i larë me agregate në dukje është një lloj betoni dekorativ dhe funksional, i cili karakterizohet nga ekspozimi i gurëve ose shëllirave të përdorura si agregate. Ky efekt krijon një sipërfaqe estetike, natyrale dhe me strukturë të dukshme, duke e bërë ideal për trotuare, trotuare dekorative, sheshe, dysHEME komerciale dhe mjedise jashtë.

Ai përbëhet nga ciment Portland, rërë të pastër dhe agregate të zgjedhura me kujdes, të cilat pas hedhjes së betonit nivelohen dhe pastrohen për të ekspozuar sipërfaqen e gurëve. Përfundimi mund të trajtohet me sealant për mbrojtje ndaj ujit, vajrave dhe ndotjes, duke ruajtur estetikën dhe qëndrueshmërinë.



Betoni i larë me aggregate ofron jo vetëm pamje tërheqëse, por edhe sipërfaqe të fortë dhe rezistente ndaj ngarkesave, cikleve të ngricës dhe përdorimit të përditshëm, duke e bërë atë një zgjedhje praktike dhe elegante për projekte të ndryshme ndërtimi.

□ **Përbërësit kryesorë**

- **Cemento:** Tipo Portland, rezistencë ≥ 32.5 MPa
- **Agregate të imta:** Rërë e larë, e pastër, me grimca 0–5 mm
- **Agregate të mëdha:** Gurë ose shëllirë 5–20 mm (sipas efektit të dëshiruar)
- **Ujë:** I pastër, pa papastërti që mund të ndikojnë në ngjitjen e betonit
- **Admixtures (opsionale):** Retardantë ose superplastifikant për punueshmëri

Proporcioni i përzierjes

Raporti standard për beton të dukshëm:

-Cimento : Rërë : Gurë = 1 : 2 : 3 (ose sipas kërkesës strukturore)

-Përdorim uji/cemento = 0.4–0.5

Rezistenca e betonit

-Rezistenca kompresive pas 28 ditësh: 25–40 MPa (sipas kërkesës)

Dimensionet dhe trashësia

-Trashësia tipike për trotuare ose dysheme: 50–100 mm

-Trashësia për elementë mbajtës ose kolonë: 150–300 mm

Metoda e larjes së aggregateve

Pas hedhjes dhe nivelimit të betonit, shtresa e sipërme spërkatet me ujë ose përdoret brushë për të zhveshur pjesën e hollë të cementit dhe për të ekspozuar agregatet.

Mund të përdoret edhe pastrimi me presion të lartë ose kimikë të lehtë për efekt më të pastër. Ngjyra e aggregateve përcakton pamjen finale: gurë të natyrshëm ose të ngjyrosur sipas dëshirës

Shtresa sipërfaqësore mund të trajtohet me sealant për mbrojtje nga lagështia, vajrat ose ndotja

Siguria dhe qëndrueshmëria

Sipërfaqja e betonit duhet të jetë e qëndrueshme ndaj rrëshqitjes, sidomos për zona të jashtme.

Rezistencë ndaj ngricave dhe cikleve uji/akulli për beton jashtë.



FOCUS ARCHITECTURE
adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Betoni pigmentuar me agregate në dukje është një lloj betoni dekorativ që kombinon ngjyrosjen uniforme të matricës së betonit me ekspozimin e gurëve ose shëllirave si agregate. Pigmenti i shtuar në masën e betonit i jep ngjyrë të qëndrueshme dhe uniforme sipërfaqes së betonit, ndërsa pas larjes së sipërfaqes, agregatet mbeten të dukshme, duke krijuar një efekt natyral dhe tridimensional. Ky beton përdoret kryesisht për trotuare dekorative, sheshe, fasada, dysHEME komerciale dhe mjedise jashtë, ku estetika dhe qëndrueshmëria janë të rëndësishme. Ai përbëhet nga ciment Portland, agregate të pastër, rërë dhe pigment mineral jo-toksik, i cili reziston ndaj dritës, ujit dhe ndikimeve atmosferike. Sipërfaqja mund të trajtohet me sealant për mbrojtje shtesë dhe për të ruajtur ngjyrën dhe shkëlqimin.

Betoni pigmentuar me agregate në dukje kombinon **estetikën, forcën dhe qëndrueshmërinë**, duke krijuar sipërfaqe vizualisht tërheqëse dhe të qëndrueshme ndaj përdorimit të përditshëm dhe ndikimeve mjedisore.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

2.4.6 Bimësia e përdorur.



Fig. 2.

- *Santolina neapolitana* 'Lemon Queen' (Lemon Queen Lavender Cotton) - Një kaçubë e bukur e vogël me gjelbërim të përhershëm që rritet 2 metra e gjatë dhe 2-3 metra e gjerë me gjethe aromatike gri-jeshile. Grupet e luleve të verdha të buta në pranverë duken si topa të vegjël pambuku të verdhë të zbehtë që kërcëjnë mbi gjeth.
- *Salvia rosmarinus*, e njohur zakonisht si rozmarina, është një kaçubë me gjethe aromatike, me gjelbërim të përhershëm, si gjilpërë dhe lule të bardha, rozë, vjollcë ose blu. Është vendas në rajonin e Mesdheut, si dhe Portugalinë dhe Spanjën. Deri në vitin 2017 njihej me emrin shkencor *Rosmarinus officinalis*, tashmë sinonim.
- *Thymus vulgaris* është një specie bimore e lulëzuar në familjen e nenexhikut Lamiaceae, vendas në Evropën Jugore nga Mesdheu perëndimor deri në Italinë jugore.
- *Myrtus communis*, mërsina e zakonshme ose mërsina e vërtetë, është një specie bimore me lule në familjen Myrtaceae. Është një kaçubë me gjelbërim të përhershëm vendas në Evropën Jugore, Afrikën e Veriut, Azinë Perëndimore, Makaronezi dhe nënkontinentin Indian, dhe gjithashtu kultivohet.
- *Arbutus unedo*, i njohur zakonisht si pema e luleshtrydhes, e quajtur edhe madrone, është një kaçubë ose pemë e vogël me gjelbërim të përhershëm në familjen Ericaceae, vendase në pellgun e Mesdheut dhe Evropën Perëndimore.
- Ulliri, emri botanik *Olea europaea*, që do të thotë 'ulliri evropian', është një lloj



FOCUS ARCHITECTURE
adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

peme ose shkurre e vogël në familjen Oleaceae, që gjendet tradicionalisht në pellgun e Mesdheut, me nënloje të egra që gjenden më larg në Afrikë dhe Azinë Perëndimore. *Cupressus sempervirens*, selvi mesdhetare, është një specie e selvisë vendase në rajonin lindor të Mesdheut dhe Iran. Ndërsa disa studime tregojnë se ka veti mjekësore moderne, ajo është më e shquar për përdorime në mjekësinë popullore, ku gjethet e thara të bimës përdoren për të trajtuar sëmundje të ndryshme.

- *Jacaranda mimosifolia* është një pemë subtropikale vendase në Amerikën Jugore Qendrore, e cila është mbjellë gjerësisht gjetkë për shkak të luleve të saj tërheqëse dhe të qëndrueshme me ngjyrë vjollce. Njihet gjithashtu si jacaranda, jacaranda blu, poui i zi, Nupur ose pema e fierit.




Fig. 3.


- *Carex acuta* është një bimë barishtore që mund të arrijë një lartësi deri në 1-1.5 metra. Ka fletë të gjata, të ngushta dhe të mprehta që shpesh janë të gjelbra ose ngjyra e gjelbër e errët. Gjethet zakonisht janë të ngushta dhe të mprehta, dhe krijojnë një shpërndarje të dendur. Ka lule që janë të vogla dhe të paqarta, të grupuara në inflorescenca që janë tipike për bimët e gjinisë Carex. Lulëzimi zakonisht ndodh në pranverë dhe verë, dhe prodhon fara të vogla.
- *Carex remota* është një bimë barishtore që mund të arrijë lartësi deri në 1.2 metra. Gjethet e saj janë të ngushta dhe të gjata, dhe zakonisht kanë një ngjyrë të gjelbër të errët. Gjethet shpesh janë të mprehta dhe kanë një strukturë të ngjashme me ato të llojeve të tjera të Carex. Ka lule të vogla që shfaqen në inflorescenca. Lulëzimi është i zakonshëm në pranverë dhe verë. Lulëzat janë të grupuara dhe krijojnë strukturën tipike për gjininë Carex.

- *Echium vulgare* është një bimë e lartë, që mund të arrijë deri në 1.5 metra lartësi. Ka një trup të ngurtë dhe të ngushtë me gjethe të gjata, të ngushta dhe të mbuluara me thumba të vogla që i japin një ndjesi të butë kur preken. Lulëzon gjatë periudhës së verës dhe ka lule të bukura, që janë zakonisht të ngjyrosura në nuanca të kaltër, purpurt ose ngjyrë rozë. Lulëzat janë të organizuara në formë spikali dhe shpesh janë të mbuluara me qumësht ose trëndafila të butë. Lulezimi mund të tërheqë shumë insekte, përfshirë bletët, të cilat janë të rëndësishme për polinimin.
- *Satureja malore* është një bimë barishtore që mund të arrijë një lartësi deri në 40-50 cm. Ka fletë të vogla, të ngushta dhe të gjelbra, të cilat janë shpesh të mbuluara me trëndafila të butë. Lulëzon gjatë verës, duke prodhuar lule të vogla dhe të bardha ose ngjyrë të verdhë, të mbledhura në grupime të ngushta. Ajo ka një aromë të fortë dhe të këndshme, që është karakteristike për këtë lloj bime.
- *Stipa capillata* është një bimë barishtore që mund të arrijë një lartësi deri në 80-100 cm. Fletët e saj janë të ngushta, të gjata dhe të mprehta, me një ngjyrë të gjelbër ose të gjelbër të zbehtë. Ajo ka një strukturë të hollë dhe shpesh ka flokë të gjatë dhe të ngjashëm me fije, që krijojnë një pamje dekorative dhe dalluese. Lulezimi i saj ndodh gjatë verës, dhe lulëzat janë të organizuara në formë panikulash. Ajo është e njohur për stilin e saj të veçantë të përhapjes së farës, e cila ka flokë të gjatë që shpërndahen me erën.
- *Origanum majorana* është një bimë barishtore e vogël që mund të arrijë një lartësi deri në 30-60 cm. Ka fletë të vogla, të theksuara, të gjelbra dhe shpesh të buta në prekje. Gjethet janë të ngushta dhe kanë një aromë të këndshme dhe të fortë kur shtrydhen. Bima lulëzon gjatë verës, prodhon lule të vogla, të bardha ose të rozë, të mbledhura në grupe të dendura.
- *Origanum vulgare* është një bimë barishtore që mund të arrijë lartësi deri në 80 cm. Ka gjethe të vogla, të thjeshta dhe të ngushta, me një ngjyrë të gjelbër të errët. Gjethet janë të mbuluara me vajra esenciale që japin një aromë të fortë dhe karakteristike kur shtrydhen. Bima lulëzon gjatë verës, duke prodhuar lule të vogla dhe të bardha, të mbledhura në grupe të dendura. Lulezimi është një proces që kontribuon në shpërndarjen e farave dhe në riprodhimin e bimës.
- *Salvia pomifera* është një specie e Mesdheut Lindor, e kufizuar në Greqi dhe në Azinë e Vogël dhe veçanërisht në ishullin e Kretës, ku njihet me emrin popullor "pikri faskomilia" (urtë e hidhur). Emri i saj tregtar është "Sage Kretës" ose "Sage Mollë".

2.4.7 Mobilimi urban.

1 Kosha te vegjel druri


Ky kosh i vogël druri është dizajnuar për përdorim të ne sheshe rezidenciale, duke ofruar stabilitet dhe siguri për fëmijë ose përdorim rekreativ. Ai është i ndërtuar nga dru i fortë dhe i qëndrueshëm (pisha ose ahu) me trashësi 18–25 mm, i lyer me lak jo-toksik ose vaj natyral për mbrojtje dhe estetikë. Unaza e koshit është e bërë nga metal ose dru i fortë, me diametër 30–35 cm. Baza e koshit është e gjerë dhe e stabilizuar, duke parashikuar edhe mundësinë e fiksimit në dysHEME për siguri shtesë. Koshi ka një dizajn të thjeshtë dhe funksional, me kënde të lëmuara për të shmangur dëmtimet, duke e bërë atë të përshtatshëm për përdorim të sigurt dhe afatgjatë në ambiente te jashtme. Koshat do të jenë të veshur me panele prej ristelash druri për t'i kamufluar dhe për tu dukur më estetikisht të pranueshëm për ambientin rrethues. Dimensionet përkatëse mund të lexohen në vizatimet teknike.



.Fig. 4.

2. Stola me beton te derdhur dhe veshje me drri

Në shesh kemi të pozicionuar stola, të cilët do realizohen me beton të derdhur në kallëpe përkatëse ku brenda do mbajnë dhe një strukturë të lehtë hekuri. Stolat janë të dimensioneve të ndryshme si në vizatimet teknike. Pjesa e sipërme e stolit do të rrafshohet me kujdes duke e lënë sa më të lëmuar dhe perzier me rërë kuarc.






Fig. 5.



3. Ndiriçues i ulët; h=1m

Përshkrim:

Ndiriçues vertikal për ambiente të jashtme, me trup cilindrik dhe shirit LED të integruar. Për përdorim përgjatë rrugicave, shesheve apo zonave të ecjes.

Përbërës kryesorë:

- Trup alumini i veshur me pluhur
- LED strip i integruar në seksion frontal
- Mbështetje në bazë rrethore për ankorim

Dimensione përfundimtare (*marrë nga vizatimi*):


- Lartësia totale: 1000 mm
- Diametri i trupit: Ø88 mm
- Diametri i bazës: Ø200 mm
- Dritarja e dritës (LED): 960 mm gjatësi, 13.3 mm gjerësi

Karakteristika ndriçimi:

- Lloj ndriçimi: LED i integruar (strip LED)
- Ton ndriçimi: 3000K (dritë e ngrohtë)
- IP65 – rezistent ndaj ujit dhe pluhurit

Materiale:

- Trup ndriçues: Alumini me veshje pluhuri anti-korrozive
- Difuzor: Polikarbonat i tejdukshëm i integruar në trupin LED



3. SEKSIONI - NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

3.1 Specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

3.1.1 R restaurimi i cative.

Restaurimi i cative do të bëhet duke ruajtur të njëjtin konfiguracion siç është paraqitur dhe në projekt.

Qëllimi: Përmirësimi i strukturës së çative

Materialet e nevojshme: Lëndë druri pishe katror e pastruar e cila mundet të jetë vendi ose importi. Dërrasa për mbulesë nën tjegulla: Petavrat duhet të jenë dërrasë pishe e stazhonuar për një kohë të gjatë me trashësi 1.5-3 cm e cila mundet të jetë vendi ose importi.

- Tjegulla të lugëta vendi mundësisht të përdorua por në gjendje të mirë me ngjyrën e vjetërsisë ose po qenë të reja me ngjyrë të pështatshme me ato ekzistuese.
- Lënda drusore e gjitha të jetë e dizifektuar nga dëmtimet e mikro organizmave dhe brejtësit e ndryshëm. Letër katrama me trashësi 2mm-5mm për hidroizolimin e çatisë.

3.1.2 Pastrim i mureve në fasadë nga pluhurat dhe depozitimet sipërfaqësore me furçë dhe larje me ujë.

Të bëhet pastrimi i mureve, nga materialet inerte të copëzuara, pluhurat dhe depozitimet e sipërfaqësore në hapësirat e krijuara nga mungesa e materialit ose nga fugat dhe në sipërfaqen e gurëve. Pastrimi bëhet manualisht me furçë dhe më pas larja me ujë. Uji duhet të ketë pH neutral dhe duhet të ruhet në kontenerë të mbyllur me temperaturë 5 - 25 °C.

Ky proces përcaktohet në vend gjatë fazës së parë të zbatimit të punimeve nën drejtimin e Mbikqyrësit të punimeve restauruese. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin e muraturës nga pluhurat dhe depozitimet.

3.1.3 Restaurim mur guri llaç gëlqere 1:3.

Punimi përfshin restaurimin e murit të gurit në pjesët ku është i dëmtuar me ripërdorimin e gurëve gëlqeror që ndodhen në vend, të cilët në fillim do mblidhen dhe sistemohen dhe më pas do rivendosen në vepër të punuar në mënyrë të çrregullt dhe në rreshta sub-horizontal me të njëjtën teknikë si muri ekzistues, ndërsa bërthama e përbërë nga po i njëjti material prej guri gëlqeror por me copa më të vogla dhe të vendosura në mënyrë të çrregullt:



3.1.4 Suvatim i jashtëm.

Në sipërfaqet e jashtme të të gjitha ndërtesave, kolonave dhe trarëve, suva të trashë dhe të imët, tulla, shtuf, beton gazuar dhe kështu me radhë. Zbatohet në sipërfaqe dhe siguron izolim të mirë.

Përzierja 10-12 litra ujë të pastër derdhen në enën ku do të përgatitet llaçi dhe shtohen 12 kg suva të izolimit të jashtëm ekologjik TermoBor . Përzierja e llaçit në të cilin do të përgatitet përzierja duhet të pastrohet tërësisht paraprakisht dhe sedimentet e grumbulluara në buzë të vaskës në kohën e përzierjes duhet të pastrohen plotësisht me një mistri çeliku dhe të përzihen përsëri. Pastaj përzihet me një mikser me 500-600 rpm për 4-5 minuta derisa të bëhet homogjene. Pas procesit të përzierjes, llaçi pushohet për 10 minuta dhe nëse është e nevojshme, shtoni 1 litër ujë më shumë sipas qëndrueshmërisë së tij dhe përziejeni përsëri dhe bëjeni gati për aplikim. Koha e përdorimit të llaçit të përgatitur është 6 orë.

3.1.5 Lyerje e fasadave me bojë hidroplastike.

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet t'i paraqesë për aprovim Supervizorit, markën, cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë.

Të gjitha bojrat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervizorit. Materiali i pastrimit të njollave duhet të jetë me përmbajtje të ulët toksikimi. Pastrimi dhe lyerja duhet të kordinohen në atë mënyrë që gjatë pastrimit të mos ngrihet pluhur ose papastërti dhe të bjerë mbi sipërfaqen e sapolyer. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra. Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH.

3.1.6 Veshje e fasadave me sistem kapot.

Përshkrimet e mëposhtme do të jenë pjesë integrale dhe të detyrueshme për zbatim nga ana e nënkontraktorit. Objekti i këtyre përshkrimeve, është suvatimi i jashtëm dhe termoizolimi (sistem Kapotë) për objektin dhe përfshin të gjitha materialet e domosdoshme për arritjen e këtij qëllimi. Qëllimi i këtij specifikimi është të përcaktojë materialet dhe formën e punës për montimin e sistemit kapotë dhe shtresave dekorative në fasada.

Për matjet e volumeve dhe të gjitha punimeve në kantier i referohemi projektit të zbatimit. Në raste se ka levizje mbi 5% nga projekti i zbatimit për pjesën në diskutim i referohemi matjeve në vend. Volumet e punës do të maten për punë të kryer në vend dhe të marë në dorëzim nga inxhinieri i kantierit sipas përcaktimeve në kontratë. Në matjet e sistemit kapotë dhe shtresave dekorative, hiqen të gjitha hapësirat boshe me dimensione më të mëdha se 1x1 metër. E gjithë hapësira e dyerve dhe dritareve nuk janë të llogaritura në sipërfaqen e suvatimit.

Gjatë fazës së punimeve do të monitorohet cilësia e materialeve dhe punimeve. Në përfundim të cdo muaji ose me kërkesë të nënkontraktorit ose grupeve të punës, do të bëhet matja e volumeve faktike të punës së marë në dorëzim. Këto volume do të paraqiten në situacionin mujor, atë progresiv të shoqëruar me librin e matjeve.

Situacioni dhe dokumentat shoqëruese përgatiten nga nënkontraktori ose grupet e punës.



FOCUS ARCHITECTURE
adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.




Fig. 11. Pamje të detajeve të veshjes kapot.

Për të piketuar fasadën e objektit duhet ti referohemi vizatimeve të projektit të zbatimit. Ky projekt është pjesë e këtyre specifikimeve. Gjatë fazës së piketimit duhet të kihet parasysh: Përpara fillimit të montimit të fasadës do të bëhet kontrolli i të gjithë sipërfaqes së mureve që përbëjnë fasadën e objektit. Do të kontrollohen të gjitha linjat horizontale dhe vertikale të fasadës. Është detyrë e nënkotraktorit të bëjë kontrollin dhe raportimin e cdo problemi që ndikon në mos respektimin e këtyre specifikimeve teknike dhe projektit të zbatimit.


Cdo difekt që lind nga neglizhenca dhe mos reklamimi i problemeve të punimeve të kryera nga të tretë, është përgjegjësi e kontraktorit të bëjë riparimet e nevojshme. Cdo piketim dhe ndryshim në projektin e zbatimit nuk mund të kryhet pa miratimin e inxhinierit të kantierit. Gjatë piketimit do të respektohet projekti i zbatimit. Sistemi do aplikohet me pllaka polisteroli EPS F120 me dendësi minimale 18-25 kg/m³ i certifikuar për sisteme kapote dhe me karakteristika teknike sipas përshkrimeve të mëposhtme. **Trashësia e panelit izolues EPS 50 mm**, sipas shkallëzimeve të përcaktuara në arkitekturë EPSF 120 është polistiren vetëshues "F" i stazhonuar Me qëndrueshmëri në ngjeshje 120 Kpa. Rezistencë në perkulje 170 Kpa. Reaksion F ndaj zjarrit referuar **EN 13501-1**. Me koeficient të përcjellshmërisë termike $< 0.036 \text{ } \ddot{\text{E}}/\text{m } ^\circ\text{K}$ Materialet e tjera të sistemit, që do të përdoren janë: Materiali ngjitës i panelit të polisterolit me murin mbajtës tulle/beton, do të jetë kollë e certifikuar dhe specifikuar përngjitje. Këndore plastike, në të gjitha këndet dhe mbylljet e sistemit kapotë. Pikore në të gjitha vetratat dhe dritaret që janë të ekspozuara ndaj ujit (jo në llozha dhe ballkone të mbuluar) Elementi fillestar (guida e nisjes profil C) dhe ai fundor do të jenë prej alumini sipas përcaktimeve të sistemit. Gozhdë plastike (Upa) minimalisht 6 copë/m² dhe duhet të jenë të përshtashme për kapje në tulla argjile dhe beton. Upa-t plastike nuk duhet të mbështeten në më pak se dy paretet e tullës, gjatësia minimale 13 cm. Ndërsa në sipërfaqet me beton të armuar nuk do të inkastrohet më pak se 4 cm. Shpimi i vrimave për montimin e upave do të kryhet me trapan me distancier ose me shënues tjetër për të kontrolluar thellësinë e shpimit.





- 1-Grafiato (shtrese dekorative)
- 2-Kolle rashinimi
- 3-Rrjete me fibra xhami/poliester
- 4-Panel polisteroli EPS
- 5-Kolle ngjitese per polisterol
- 6-UPA plastike per fiksimin e polisterolit (> 13cm)
- 7-Tulle
- 8-Suva e brendshme

Fig. 12. Inkastrimi i UPA-ve në tullë armuar.



- 1-Grafiato (shtrese dekorative)
- 2-Kolle rashinimi
- 3-Rrjete me fibra xhami/poliester
- 4-Panel polisteroli EPS
- 5-Kolle ngjitese per polisterol
- 6-UPA plastike per fiksimin e polisterolit (> 13cm)
- 7-Beton i armuar
- 8-Suva e brendshme

Fig. 13. Inkastrimi i UPA-ve në beton të armuar.

Rrjetë armature me fibra xhami/poliester, 140 gr/m² e specifikuar dhe certifikuar për sisteme kapotë dhe rashinim me kollë. Rjeta do të mbivendosen minimalisht 10% të gjerësisë së saj. 84 Në pjesët e dritareve dhe hapësirave të tjera do të përforcohet me shirita me gjerësi 30 cm, të montuara në formë diagonale në këndet e hapësirave. Kollë (ngjitës) për mbulim/nivelim të rrjetës plastike (dora e parë). Kjo kollë do të mbulojë të gjithë rrjetën. Aplikohet fillimisht një shtresë kollë me trashësi 3-4 mm në mbi panelet e polisterolit dhe më pas në gjendje të freskët montohet rrjeta plastike duke e shtruar më mallë metalike. Përpara montimit të rrjetës do të montohen të gjitha këndoret dhe pikoret. Kollë për mbushje/drejtim të sipërfaqes (dorë e dytë). Sjtresa do të aplikohet për mbulimin e rrjetës dhe përgatitjen e sipërfaqes për montimin e shtresës dekorative.



FOCUS ARCHITECTURE
 adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
 e-mail: f.architecture@yahoo.com
 mob.1: +355 69 4006658
 mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Kjo shtresë duhet të jetë e sheshtë dhe pa deformime. Në rast kur kërkon inxhinieri i kantierit do të ashpërsohet sipërfaqja e saj me furcë plastike ose metalike për aplikimin e materialeve të tjera. Material lidhës (astar) përpara grafiatos, kur specifikohet nga prodhuesi i materialit. Shtresa dekorative, grafiato akrilike 2~3 mm me granulometri dhe ngjyrë të përcaktuar nga projekti arkitektonik. Në rastet kur nuk specifikohet ndryshe, grafiato do të punohet pa lule dhe do të shpërndalet me mallë dhe përdaf mesfungsier.




Fig. 14. Elementët përbërës të sistemit kapot.

Për të arritur parametrat e duhur teknikë të reduktimit të humbjeve termike në ndërtesa është shumë i nevojshëm përdorimi i produkteve të certifikuara, të shoqëruar me certifikatat përkatëse, pasi përdorimi i produkteve të tjera nuk garanton cilësinë dhe efektin e duhur. Profilat, gozhdat plastike, rrjetat, këndoret, dhe shtresat finale duhen të jenë pjesë të një sistemi të certifikuar, STO, ROFIX, MAPEI (ose të ngjashëm) si dhe të aprovuara nga stafi i kantierit përpara aplikimit, sipas një formati dhe procedure të përcaktuara. Përpara aplikimit do bëhet rregullimi dhe pastrimi i fasadës egzistuese të tullave, me ujë deri sa të thahet, ose me primer për ngjitjen e kollës. Duhet të kihet kujdes gjatë ngritjes së skelerisë dhe cmontimit të saj për dëmtime të mundshme të sistemit. Skela duhet të kapet dhe të sigurohet në pika të cilat nuk e dëmtojnë sistemin KAPOT, dhe këto pika duhet të riparohen në momentin e cmontimit të saj me elementët e duhur. Detaji i fillimit, bashkimet me pjesët e tjera të fasadës, detaji pranë dyerve dhe dritareve, detaji i fundit, afër fugave, duhet të jenë sipas materialit bashkangjitur dhe instruksioneve të inxhinierit të kantierit.






Fig. 15. Detaje të montimit të sistemit kapot.

Implementimi i sistemit kapotë do të bëhet konform projektit arkitektonik të fasadës dhe materialit bashkangjitur, udhëzimeve të prodhuesit, dhe konform standarteve ETAG 004, EN 13501-1. Në fasadë do të ketë pjesë që nuk kanë nevojë për veshje me polisterol. Ato pjesë do të suvatohen dhe trajtohen me boje.




Fig. 16. Paraqitje grafike e montimit të pllakave të polisterolit.



FOCUS ARCHITECTURE
 adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
 e-mail: f.architecture@yahoo.com
 mob.1: +355 69 4006658
 mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Puna për aplikimin e sistemit do të nisë pasi të jete pastruar muratura e tullës nga papastërtitë dhe nga llacrat e fugave që mund të dalin jashtë muraturës. Aplikimi i sistemit do të fillojë vetëm pasi të jetë verifikuar që muratura ku do të aplikohet është brenda kërkesave dhe standartit të kërkuar. Nuk lejohet që të fillojë aplikimi nëse në muraturë ka zgavra, papastërti, shtrëngime me pyka druri ose tulle. Skleria do të montohet në distancën e duhur për lejimin e punës. Materiali që do të aplikohet do të jetë i miratuar sipas procedurës seinvestitorit. Montimi i pllakave të polisterolit do të bëhet me kollë në të gjithë gjerësinë dhe gjatësinë e tyre dhe jo me disa pika. Pllakat e polisterolit do të montohen në mënyrë të tillë që të mbështeten tek njëra-tjetra në 1/3 e gjatësisë në formë muri tulle dhe do të nisin nga poshtëllartë duke u mbështetur në elementin fundor të sistemit. Pas montimit të pllakave sipas rradhës së mësipërme duhet të kalohet shtresa e parë me kollë sëbashku me rrjetën me fibra xhami dhe 24 orë më pas duhet të kalohet shtresa e dytë e kollës. 24 orë pas kalimit të shtresës së dytë të kollës fillon montimi i vidave (upa-ve) plastike të përshtashme si për tulla argjile si për elemente betoni jo më pak se 6 copë/m². Pikat ku do të montohen vidat (upat) duhet të stukohen që të mos jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me shtresat e tjera. Në cdo kënd ose thyerje duhet të realizohet duke vendosur këndoren e sistemit. Këndorja duhet të montohet në mënyrë të tillë që të mos dallojë si në horizontalitet dhe vertikalitet nga pjesa tjetër e sistemit. Pasi të thahen edhe stukimet duhet të aplikohet një shtresë prajmer (ngjitës astar) përpara aplikimit të grafiatos. Grafiato aplikohet 24 orë pas aplikimit të astarit ose sipas specifikave të prodhuesit. Grafiato do të jetë akrilike dhe me ngjyrë sipas kërkesave të investitorit. Në rastet kur skleria e montuar për këtë sistem është fiksuar në brendësi të sistemit, kur të nisë cmontimi i skelës duhet të merren masa që të bëhen riparimet e nevojshme në sistem duke aplikuar materialet e duhura dhe radhën e punës e cila do të miratohet më pare nga inxhinieri dhe nga investitori.

3.1.7 Vendosja e ulluqeve vertikale dhe horizontale.

Materiali i ulluqeve vertikale do të jetë bakri. Impluvet e llamarinës do të jenë xingato dhe do të vendosen në pozicionet ku kanë qenë ekzistueset. Duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6mm dhe diametër 10cm.

Do të fiksohen me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 1 m. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të. Ky çmim është për njësi Lekë/ml.

3.1.8 Lyerje me bojë vaji e sipërfaqeve metalike.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet të kryhen për pastrimin e sipërfaqes së kangjellës. Elementet ekzistues duhet të pastrohen nga ndryshku me furçë të ashpër dhe duke i fërkuar me shtupë leshi sipas rastit. Stukim dhe zmerilim të elementeve prej hekuri duke përdorur stuko të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqeve për lyerjen me bojë vaji. Lyerje e elementeve prej hekuri, me bojë të përgatitur fillimisht me një dorë minio plumbi ose antiruxho ose në formën e vajit sintetik, me dozim per m², 0.080 kg. Lyerje me bojë vaji sintetik për sipërfaqe metalike, me dozim per m²: bojë vaji 0.2 kg dhe me shumë duar për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lyerjes me bojë vaji në mënyrë perfekte. Ky çmim përfshin në tërësinë e tij punën e bërë për pastrimin e lyerjen, blerjen e materialeve, transportin e tyre në objekt.



3.1.9 Lyerje e sipërfaqeve të drurit.

Lyerja e elementëve drusorë do të bëhet për të mbrojtur këto elemente si dhe uniformizuar ngjyrën e të gjithë këtyre elementëve. Për elementët origjinalë të lyer me vaj lini do të pastrohet paraprakisht sipërfaqja nga pluhurat dhe depozitimet me kompresë me ujë të ngrohtë si dhe me alkool të holluar në ujë dhe më pas do të vazhdohet lyerja me vaj lini pa ngjyrë në mënyrë që të evidentohet ngjyra origjinale e elementëve. • Për elementët drusorë të lyer me bojë vaji apo llak, do të bëhet pastrimi e zmerilimi i sipërfaqes sic e kemi shpjeguar më sipër në mënyrë që të arrihet përthithja e vajit të linit me ngjyrë të errët sipas ngjyrës së evidentuar të elementëve origjinalë. Vaji i linit duhet të jetë i shumë i pastër, me erë të fortë dhe shije të hidhur, i papërzier me vajëra mineral, vaj peshku apo të ndonjë lloji tjetër. Nuk duhet të lërë asnjë depozitim mbetje nëse e hedhim në lastër qelqi apo metali. Duhet të lihet të thahet komplet në intervalin e 24 orëve. Nuk duhet të ketë më tepër se 7% aciditet, 1% papastërti dhe në temperaturën 15°C një densitet 0.91-0.93. Lyerja duhet të bëhet me vaj lini. Përpara fillimit të këtij procesi mbikqyrësi i punimeve të restaurimit, duhet të bëjë një kontroll të kujdesshëm të përcaktojë dhe lërë qartë detyrat kontraktorit për trajtimin e secilit element sipas përcaktimeve të mësipërme. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me vaj lini të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të. Ky çmim është për njësi Lekë/m². 3.1.6

3.1.10 Shkallë me beton të larë me agregate në dukje.

Agregatet duhet të zgjidhen në përputhje me DIN EN 206. Në përgjithësi, të gjitha rërat natyrale dhe zhavorret, gurët e thërrmuar apo produktet e tjera të cilët janë provuar më parë në praktikë mund të përdoren si agregatë me kusht që të jenë plotësuar kërkesat e 50 specifikuara. Agregatet nuk duhet të përmbajnë ndonjë substancë që mund të neutralizojë alkalinitetin e betonit.

3.1.11 Korimanot metalike.

Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për të plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitektonike të njëndërtimi. Duhet që korimonat të jenë të larta 100-110 cm. Në raste kur gjatësia e shkallëve është më e madhe se 12 m korimonat duhet të jenë 110 cm të larta. Masa prej 100/110 cm varet edhe prej sipërfaqes të sheshpushimit. Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëve, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Korimanot ose duhen mbuluar me elemente druri mund të sigurohen me ristela prej druri ose metali. Listelat ndërmjet tyre duhet të jenë më pak se 12 cm. Në rastet kur shkallët janë më të gjëra se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parmakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parmakët nëpër shkallë nuk duhet të jenë më të ulëta se 75 cm dhe jo më të larta se 110 cm. Kur flitet për njësi banimi ata të vendosen në një lartësi prej 80 cm. Parmakët duhen larguar nga muret min. 4 cm. Parmakët, preferohet të vendosen prej një materiali dhe forme të tillë, që prekja e tyre të jetë e lehtë dhe pa dëmtime. Preferohet që parmakët të prodhohen prej druri, sepse parmakët prej çeliku të lenë një përshtypje të ftohtë. Për vendosjen e xhamit duhet që ai të jete me spesor jo më pak se 1.5 cm dhe të fiksohet mire me pjesen e struktuesmetalike.



3.1.12 Dritare, dyer/ Informacion i përgjithshëm/ Kërkesat.

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Në bazë të vizatimeve teknike në projekt carjet në fasade janë 351 x 150 cm të cilat nuk do jene si dritare te zakonshme por do te realizohen me panele polycarbonat si ne detajet perkatese te vizatimeve. Ne katin e dyte kemi strukturen metalike te veshur rreth e perqark me panelet polycarbonate.

Dyert janë një pjesë e rëndësishme e ndërtesave. Ato duhet të sigurojnë hyrjen në pjesët e brendshme të tyre. Në varësi të funksionit që kanë, dyert mund të jenë të brendshme ose të jashtme. Madhësitë (kupto dimensionet) e tyre janë të ndryshme në varësi të kompozimit arkitektonik, kërkesave të projektit dhe të Investitorit. Dyert mund të jenë të prodhuara me dru, MDF, metalike, duralumini, plastike etj. Pjesët kryesore të dyerve janë:

- Kasa e derës e fiksuar në mur dhe e kapur nga ganxhat, vidat prej hekuri përpara suvatimit (materiale te dritares mund të jenë metalike, duralumini ose prej druri të fortë të stazhionuar);
- Korniza e derës e cila lidhet me kasën me anë të vidave përkatese pas suvatimit dhe bojatisjes;
- Kanati i derës i cili mund të jetë prej druri, metalike, alumin ose PVC te përforcuara sipas materialit përkates, si dhe aksesoret e derës, ku futen mentesha, dorezat, çelesat, vidat shtrënguese, etj.

Pjesët përbërëse të çdo lloj dere janë në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për secilën prej llojeve të dyerve pjesët përbërëse do të jenë si më poshtë: Dyert e brendshme prej druri pishe (tualetet), të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë do të përbëhen nga:

Një kasë me binarë pishe, kur dyert janë me dhëmbë, me përmasa 7x5cm, që mbërthehet në mur me ganxha e me llaç çimento.

Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë më sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Korniza do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e bravës për të gjitha llojet e dyerve (Dyer me kasë binarë, dyer pa kasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj).

Kanatet hapëse me kornizë të drunjtë (tamburate) të bërë me një kornizë druri të fortë (janë me përmasa minimalisht 10 x 4 cm), pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion çdo 40 cm. Në pjesën e poshtme, paneli më i ulët horizontal do të jetë në një lartësi prej 20 cm nga fundi. Kanatet me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 3 cm) dhe e trajtuar me mbulesë.

Mbrojtëse të drunjtë dhe të përforcuar në pjesët e brendshme me struktura druri, të cilat duhet të sigurohen të paktën nga 3 mentesha me gjerësi minimale 16cm.

Një bravë metalike sekrete dhe tre kopje çelësash, doreza dyersh dhe doreze shtytëse të derës.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE

e-mail: f.architecture@yahoo.com

mob.1: +355 69 4006858

mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për secilin prej llojeve të dyerve vendosja në vepër duhet të bëhet si mëposhtë:

Dyert e brendshme prej druri pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjtë do të instalohen sipas kësaj rradhe pune:

një kasë dërrase e bërë me dru pishe të stazhionuar (me trashësi 4 cm) ose kasë binare

6 x 5 cm, e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit) mbërthehet fuqishëm në mur me ganxha ose me vida hekuri (çdo një metër) dhe me llaç çimento;

Një kornizë e kasës së drurit fiksohet tek kasa e drurit pas suvatimit dhe lyerjes. Korniza

do të sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelësit për të gjitha llojet e dyerve (Dyer me kasë dërrase, binare me dyer pakasë, me dritë në pjesën e sipërme, etj). Në këtë kornizë do të fiksohen mbulesat mbrojtëse të drunjtë dhe shiritat e sigurisë me dru të fortë të siguruar nga një bravë sigurie. Trashësia totale e dyerve do të jetë 4,5 cm minimalisht.

një bravë metalike dhe tre kopje çelësash tip sekret si dhe doreza e dyerve. Instalimi i Dyerve të brendshme prej duralumini:

Për dyert e banjove apo të tjera:

Çdo dorezë vepron me vidën e posaçme për kyçje kur bëhet kyçja nga kthimi i thumbit të futur.

Një pjesë metalike e futur dhe e kthyer për rastet e emergjencës do të çkyçë derën nga jashtë.

Në se Kontraktori do të instalojë brava me leve tip Tubolare (Ato janë veçanërisht të përdorshme për femijët dhe handikapet), të dhënat teknike të tyre duhet të jenë si më poshtë:

Shasia prej çeliku dhe kasa e fishekut të kyçjes të vëndosur në një pjesë të zinguar për mbrojtje nga korrozioni.

Garancia e Braves mbi 150 000 ciklejete

Gjuza duhet të jetë prej zinku me mbrojtje katodike ose bronx solid.

Bravat duhet të jenë të kyçshme me një vidë të posaçme për të rritur sigurimin e derës,

Bravat duhet të jenë të kyçshme në një kombinim të thjeshtë dhe përdorim të lehtë, Bravat duhet të jenë të lehta për tu instaluar.

Trashësia e mbulesës mbrojtëse duhet të jetë 1 mm dhe diamteri i saj duhet të jetë 67 mm,

Thellësia e fishekut të kyçjes duhet të jetë 60-70mm,

Dorezat duhet të jenë plotesisht të kthyeshme nga ana e djathtë e derës,

Trashësia e derës duhet të jetë 35mm-50mm sipas standartit

Të zbatueshme për çelësat tip Yale sipas standartit por mund të jenë të zbatueshme edhe për mundësi të tjera të çelësave.

Pjesa e kthyeshme duhet të jetë e përshtatshme deri në 60 - 70 mm. Bravat me leve tip Tubolare mund të përdoren për dyer thyrëse, dyert e banjove ose për dyert që nuk kanë nevojë për kyçje.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANË

e-mail: f.architecture@yahoo.com

mob.1: +355 69 4006658

mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Për dyert hyrëse do të kemi:

Fishek kyçës për kyçe të posaçme

Çelësi ose doreza me thumb të kyçë dhe të çkyçe brenda dhe jashtë gjuzën e braves

Kthim nga brenda i thumbit kyçës ose çelësi do të mbylle gjuzën. Kthimi në drejtim të kundërt do të çkyçe gjuzën.

Për dyert e banjove apo të tjera :

Gjuzat e jashtme dhe të brendshme veprojnë me vidën e posaçme për kyçe kur bëhet kyçja nga kthimi i thumbit të futur.

Një pjesë metalike e futur dhe e kthyer për rastet e emergjencës do të çkyçe derën ngajashtë.

Për dyert që nuk kanë nevojë për kyçe do të kemi:

Gjuza të jashtme dhe të brendshme veprojnë me fishekune kyçjes gjatë të gjithë kohës.

I përshtatshëm për përdorim në dhomat e ndenjes, guzhinat apo dhomat

Në se Kontraktori do të instaloje brava tip Cilindrike, të dhënat teknike të tyre duhet të jenë si mëposhtë:

Shasia prej çeliku dhe kasa e fishekut të kyçjes të vendosur në një pjesë të zinguar për mbrojtje ngakorrozioni.

Garancia e Braves mbi 150 000 ciklejete

Gjuza duhet të jetë prej çeliku inoksi osebronxi.

Bravat duhet të jenë të kyçshme në grup për te përmirësuar paraqitjen,

Bravat duhet të jenë të kyçshme në një kombinim të thjeshtë për familjet dhe përdorim të lehtë,

Bravat duhet të jenë të lehta për t'u instaluar.

Cilindrame 5 kunj,prize bronzi me tre çelësa bronzi të larë me nikel.

Trashësia e mbulesës mbrojtëse duhet të jetë 2mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28x 70mm,

Thellësia e fishekut të kyçjes duhet të jetë 12,5mm,

Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majtë e derës,

Trashësia e derës duhet të jetë 35 mm - 50 mm sipas standartit ose në raste të veçanta 50-70mm.

Të zbatueshme për çelësat tip Yale sipas standartit por mund të jenë të zbatueshme edhe për mundësi të tjera të çelësave.

Pjesa e kthyeshme duhet të jetë e përshtatshme deri në 60-70mm.

Bravat tip Cilindrike mund të perdoren për dyert hyrëse, dyert e banjove, për dyert që nuk kanë nevojë për kyçe ose dhomat e ndenjes.

Për dyert hyrëse do të kemi:

Fishek kyçës për kyçe të posaçme

Butoni shtytës në dorezën e brendshme kyç dorezën e jashtme

Doreza e jashtme gjithmonë active

Kthimi i dorezës së brendshme ose çelësit çkyç fishekun e kyçjes

Çdo Dorezë vepron tek fisheku përveç rastit kur doreza e jashtme është e mbyllur nga brenda.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE

e-mail: f.architecture@yahoo.com

mob.1: +355 69 4006658

mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

Për dyert e banjove apo të tjera :

Çdo dorezë vepron me vidën e posaçme për kyçje pa dorezën e jashtme që është e mbyllur nga shtyrja e butonit në brendësi.

Doreza e brendshme gjithmone aktive

Një pjesë metalike e futur dhe e kthyer për rastet e emergjences do të çkyçe derën nga jashtë.

tytës kyç dorezën e jashtme.

Për dyert që nuk kanë nevojë për kyçje do të kemi:

Çdo dorezë vepron me fishekun e kyçjes gjatë të gjithë kohës.

I përshtatshëm për përdorim në dhomat e ndenjes, guzhinat apo dhomat e fjetjes së fëmijëve

Për përdorim në dyert e dhomave të ndenjes, hoteleve dhe dyert dalëse do të kemi:

Fisheku i kyçjes vepron me dorezën e brendshme dhe çelësin nga jashtë.

Doreza e brendshme gjithmone active

Doreza e jashtme është gjithmonë rigjide

Në se Kontraktori do të instalojë Brave me levë tip Cilindrike, të dhënat teknike të tyre duhet të jenë si mëposhte:

Shasia prej çeliku dhe kasa e fishekut të kyçjes të vendosur në një pjesë të zinguar për mbrojtje nga korrozioni.

Garancia e Bravës mbi 150 000 cikle jete

Gjuza duhet të jetë prej zinku me plate gize ose bronx solid.

Bravat duhet të jenë të kyçshme me vide të posaçme për kyçje për të rritur sigurinë,

Bravat duhet të jenë të lehta për tu instaluar.

Cilindrame 5 kunj,prize bronzi me tre çelësa bronzi të larë me nikel.

Trashësia e mbulesës mbrojtëse duhet të jetë 2mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28x 70mm,

Thellësia e fishekut të kyçjes duhet të jetë 12,5mm,

Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majte e derës,

Trashësia e derës duhet të jetë 35mm-50mm sipas standartit.

Të zbatueshme për çelësat tip Yale sipas standartit por mund të jenë të zbatueshme edhe për mundësi të tjera të çelësave. Bravat me levë tip Cilindrike mund të përdoren për dyert hyrëse, dyert e banjove, për dyert që nuk kanë nevojë për kyçje ose dhomat e ndenjes. Të gjitha punimet e instalimit duhet të bëhen sipas kërkesave për kompletimin e një pune me cilësi të lartë Një shembull i bravës që do të përdoret duhet ti jepet për

shqyrtim Supervisorit për aprovim paraprak parafiksimit.



FOCUS ARCHITECTURE
adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob.1: +355 69 4006658
mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

3.1.13 Vendosja e dritareve, grilave dhe dyerve të jashtme prej druri.

Telajo dërrase (me seksione minimum 7 x 4 cm), mentesha dhe bllokues për tipe të ndryshëm dritarësh, kanate dritare, sopraluçe, doreza, xhama (me trashësi 4 mm kur janë transparent dhe 6 mm kur janë të përforcuara me rrjet teli), listela druri të plotë, ngjitës transparent silikon, bllokues dritarësh me zinxhir ose kompas. Përshkrimi i punës: Furnizim dhe vendosje dritare, përmasat e të cilës duhet të përcaktohen sipas projektit dhe realizohen nga prodhuesi në vendin e prodhimit, në dru pishe të stazhionuar, i imprenjuar e përbërë nga: një kontratelajo dërrase (me gjerësi 3 cm, me madhësi sa kasa e dritares) që do të vendoset në mur me fasheta hukuri përpara punimeve të suvatimit.

Një telajo dërrase (me seksione min 7x4cm) që do të vidhoset në kontratelajo pas kryerjes së suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatim telajo do të pajiset me mentesha dhe bllokues për tipe të ndryshëm dritarësh, kanate dritare, superliça etj. shirita druri të plotë rreth perimetrit të dritares nga brenda, kur realizohen paturë dhe nga brenda e jashtë në mungesë të paturës (dhëmbit) me duke përfshirë bërjen e shpatullave të muraturës, si dhe çdo pajisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë preçize kampione të artikujve të propozuar, do ti paraqiten paraprakisht supervizorit për aprovim paraprak. Dritare me kanate të pahapshëm të pajisur me: xhama (me trashësi 4mm kur janë transparent, 6mm kur janë të përforcuar me rrjete teli, ose me dopio xham), fiksuar me listela druri të plotë dhe ngjitës transparent silikon, bllokues dritarësh me zinxhir ose kompas.

Dyert e jashtme prej druri të fortë pishe, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte do të përbëhen nga: • Një kasë druri që fiksohet në mur me anë të ganxhave në formë thike prej çeliku përpara suvatimit. (Gjerësia e kasës është 3 cm kurse gjerësia

e saj sipas madhësisë së murit). 0| Kasa binare për dyer me dhëmbë kur dyer janë me dhëmbë, me përmasa 7 x 5 cm, që mbërthehet në mur me ganxha dhe me llaç çimentoje. • Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë me sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknike, korniza do të sigurohet • me mentesha dhe ankerat e çelësit gjatë instalimit të pjesëve hapëse të derës. Kanatat hapëse me kornizë të drunjte (tamburate) janë me përmasa minimalisht 10 x 3 cm, pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion dhe me një lartësi të fundit prej 25 cm e cila është e ndarë me panele prej druri të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte. Ajo është e kompletuar me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse). • Dy mbulesa të drunjta me trashësi 2-3 mm (një nga çdo anë). Përmasat do të jenë në varësi të madhësisë së derës së përcaktuar në projekt.

Mbulesat mund të jenë të rrafshta ose me gdhendje. 0| Bravat e sigurse së lartë së bashku me tre kopje çelësi tip sekret si dhe aksesoret e nevojshëm për instalimin e tyre. Bravat duhet të jenë tip Cilindrike, me shasi prej çeliku dhe kasë të fishekut të kyçjes në platë zinku, me cilindra tip kunjash. Bravat duhet të jenë të kyçshme në grup dhe të zbatueshme për çelësat sipas standartit. • Menteshat (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse) në tre pika ankorimi. Dorezat përkatëse, me butonin shtytës në dorezën e brendshme që kyç dorezën jashtme. Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majte e derës. Doreza e jashtme duhet të jetë gjithmonë aktive, ndërsa kthimi i dorezës së brendshme ose çelësit të bëjë ç'kyçjen e fishekut.



3.1.14 Menteshat.

Furnizimi dhe fiksimi i menteshave të bëra me material çeliku inoks ose të veshur me shtresë bronxi, sipas përshkrimeve të dhëna në Vizatimet Teknike, do të bëhet sipas standartit dhe cilësisë. Materiali i çelikut duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e lartë të menteshave, mos thyeshmërinë e tyre ndaj goditjeve mekanike, elasticitetin e duhur të menteshave, jetëgjatësinë prej 180 000 cikle jete gjatë punës, etj.

Menteshat duhet të jenë të përbëra prej:

Ku një prej çeliku të veshur me shtresë bronxi, me fileto, tip mashkull;

Ku një prej çeliku të veshur me shtresë bronxi, tip femër;

Katër vidat e çelikut që përdoren për mberthimin e tyre në objekt.

Forma dhe përmasat e pjesëve përbërëse jepen në Vizatimet teknike. Të dy kunjat e mësipërm duhet të levizin lirshëm tek njëri tjetri duke bërë të mundur një lëvizje sa më të lehtë të kornizës së derës ose të dritares kundrejt kasës së tyre. Gjatë montimit si dhe gjatë shfrytëzimit këto kunjat mund të lyhen me vaj për të eliminuar zhurmat që mund të bëhen gjatë punës së tyre. Menteshat që përdoren për dyert përbëhen prej dy kunjave të mësipërm dhe 4 vidave metalike për mberthimin e tyre. Kunjat me fileto tip mashkull duhet të jenë me diametër $d=14-16$ mm. Gjatësia e kunjit tip mashkull është $L1 = 60$ mm kurse gjatësia e filetës së tij duhet të jetë të paktën $L2 = 40$ mm. Ky kunj filetohet në kornizën e derës sipas përshkrimit të dhënë në Vizatimet Teknike. Koka e kunjit duhet të jetë në formën e kokës të gurit të shahut. Kunji metalik tip femër mberthehet me anë të katër vidave metalike në pjesën tjetër të derës. Menteshat e poshtme që vendosen në derë duhet të jetë jo më shumë se 25cm mbi pjesën e poshtme të kornizës së derës. Menteshat që përdoren për dritaret përbëhen prej dy kunjave të mësipërm dhe 4 vidave metalike për mberthimin e tyre. Kunjat me fileto tip mashkull duhet të jenë me diametër $d=12-13$ mm. Gjatësia e kunjit tip mashkull duhet të jetë $L1 = 50$ mm kurse gjatësia e filetës së tij duhet të jetë të paktën $L2 = 30$ mm. Koka e kunjit duhet të jetë në formë të rrumbullakët. Ky kunj filetohet në kornizën e dritares sipas përshkrimit të dhënë në Vizatimet Teknike. Kunji metalik tip femër mberthehet me anë të katër vidave metalike në pjesën tjetër të dritares. Menteshat e poshtme që vendoset në dritare duhet të jetë jo më shumë se 15 cm mbi pjesën e poshtme të kornizës së dritares. Gjatë montimit të dyerve duhet të vendosen të paktën 3 mentesha në tre pika ankorimi në largësi minimale prej njëra tjetres $L_{min} = 50$ cm dhe për dritaret 2 mentesha në largësi minimale prej njëra tjetres me $L'_{min} = 30$ cm. Lloji i menteshave që do të vendosen janë të përcaktuara në projekt. Ato janë në varësi të llojit dhe madhësisë së dyerve dhe dritareve.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Një model i menteshës, së bashku me çertifikatën e cilësisë dhe të origjinës së mallit, duhet ti jepet për shqyrtim supervisorit për aprovim para se të vendoset në objekt.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE

e-mail: f.architecture@yahoo.com

mob.1: +355 69 400668

mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

3.1.15 Dorezat.

Të përgjithshme:

Dorezat e dyerve/dritareve duhet të jenë të njejta në të gjitha ambientet e shkollës. Në mënyrë që të plotësohet ky kusht duhet që këto doreza të jenë të tilla, që mund të përdoren si në ambientet e thata ashtu edhe në ato me lagështirë. Kriteret që duhet të plotësojnë Dorezat e dyerve dhe të dritareve duhet të jenë:

Të kenë shkallë të lartë sigurie në përdorim (jetëgjatësi gjatë përdorimit të shpeshtë); Jetëgjatësia e dorezave varet kryesisht nga materialet me të cilat janë prodhuar ato, si dhe nga mënyra e lidhjes së dorezës me elementët e tjerë (cilindrit, bravës etj.) Për këtë sugjerohet që të zgjidhen doreza, të cilat janë prodhuar me material të fortë dhe rezistentë psh. Çelik jo i ndryshkshëm.

Të garantojnë rezistencë momentale ndaj ngarkesave (të sigurojë qëndrueshmëri në rastet e keqpërdorimit: varjet, goditjet, përplasjet etj); Duke patur parasysh përdoruesit e këtyre dorezave, duhet që ato të kenë koeficientë të lartë qëndrueshmërie në ngarkesë, pra duhet ti rezistojnë peshës së fëmijëve tek doreza. Sipas normave Evropiane (DIN) ekzistojnë dy klasa qëndrueshmërie. Tabela e mëposhtme paraqet ngarkesat për këto dy klasa nga të cilat për rastin tonë do të sugjerohet klasën ES2.

Të mos shkaktojnë dëmtime fizike gjatë përdorimit.

Përsa i takon kësaj pike duhet të themi se meqënëse këto doreza do të montohen në dyert dhe dritaret e kopshteve, shkolla fillore, tetëvjeçare e të mesme, pra do të përdoren nga fëmijë duhet që dorezat të zgjidhen të tilla, që të mos shkaktojnë dëme fizike tek fëmijët.

Në rast modeli i dorezës i paraqitur në tabelën e mëposhtme i plotëson të gjitha kushtet, meqënëse ajo përdoret më shumë në ambientet e brendshme dhe është më e sigurtë, për rastet e largimit të emergjencës, pasi është në formë rrethore.

Montimi

Përpara se të bëhet montimi i dorezave ato duhet ti tregohen supervizorit dhe vetëm pas miratimit të tij të bëhet montimi. Montimi i dorezave duhet të bëhet i tillë që të plotësojë kriteret e lartpërmendura. Në montimin e dorezës duhet të zbatohen me korrektësi të plotë udhëzime të dhëna nga ana e prodhuesit të saj.

3.1.16 Vendosja e portave të jashtme metalike.

Furnizim dhe vendosje e Portës metalike rreshqitese, me hapje automatke, e instaluar ne hyrjen kryesore, realizuar me nje kase kryesore me profil hekuri 50x50. Kasa e dyte do te behet me diameter 16 mm, te vendosura dhe të salduara sic tregohet ne projekt.

Porta do te pajiset me ganxha hekuri dhe brave sigurie me celesa dhe sistem mbylles elektrik, doreze dhe fashete, pjese speciale per mbylljen e Portës si dhe aksesore te tjere, skelat e sherbimit, si dhe çdo gje tjeter per ta konsiderur Portën te perfunduar dhe funksionuese ne menyre perfekte.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE

e-mail: f.architecture@yahoo.com

mob.1: +355 69 4006658

mob.2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

3.1.17 Vendosja e qepenave metalik të dyqaneve.

Qepeni metalik i modelit (C) është një element sigurie për hapjet e dyqaneve, i realizuar me konstruksion të qëndrueshëm çeliku. Struktura e tij lejon transparencë të pjesshme dhe mbrojtje efektive, ndërsa dizajni i integruar përshtatet me linjat horizontale të fasadës pa e prishur ritmin arkitektonik.

Qepeni metalik i paraqitur është një element mbrojtës për dyqanet, me dimensione të përgjithshme 300 cm gjerësi dhe 250 cm lartësi. Struktura ndahet në tre zona funksionale: një panel i sipërm 50 cm dhe një panel i poshtëm 70 cm me llamarinë horizontale të fortifikuara, të cilat sigurojnë mbrojtje dhe stabilitet, si dhe një pjesë qendrore 130 cm të lartë e realizuar me rrjetë metalike të dendur me formë romboidale, e cila mundëson dukshmëri të brendshme edhe kur qepeni është i mbyllur. Ky kombinim i paneleve të plota dhe rrjetës ofron siguri maksimale, ventilim dhe njëkohësisht e bën elementin vizualisht më të lehtë, duke u përshtatur me nevojat funksionale dhe estetike të hapësirave tregtare.




Fig. 17.



Fig. 18.



FOCUS ARCHITECTURE
 adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
 e-mail: f.architecture@yahoo.com
 mob. 1: +355 69 4006858
 mob. 2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.

3.1.18 Vendosja e elementeve metalike kornizuese për vendosjen e logos së dyqaneve.

Elementi i paraqitur është një kornizë metalike e integruar mbi hapjet e dyqaneve për vendosjen e logos dhe emërimit të tij, me lartësi 40 cm dhe gjerësi të përshtatur sipas fasadës ($a=35$ cm). Korniza është realizuar me material çeliku të galvanizuar, sipërfaqja e të cilës përfshin një letër të plastifikuar dhe të ngjitur me dimensione 20x155 cm, mbi të cilën shënohet emri i dyqanit. Teksti është realizuar me fontin Freestyle Script, madhësia 14, dhe me ngjyrë RAL 9010, duke krijuar një diferencë të lexueshme mbi sfondin e errët të kornizës metalike. Ky element shërben si sinjalistikë e qartë dhe e unifikuar për të gjitha njësitë tregtare. Dizajni i saj minimalist harmonizohet me fasadën ekzistuese pa krijuar kontrast të panevojshëm, ndërsa ofron një zgjidhje unifikuese dhe të standardizuar për shënjimin e dyqaneve. Dimensionet e elementeve arkitektonikë të propozuar për restaurimin e fasadave do të përshtaten në varësi të përmasave dhe karakteristikave të elementeve ekzistues, me qëllim ruajtjen e harmonisë vizuale dhe integritetit historik të ndërtesës. Përmasat e grilave, vetratave, dyerve, qepenëve dhe tabelave sinjalistike do të ndjekin modulimin origjinal të hapjeve dhe raportet ekzistuese të fasadës, duke respektuar gjerësinë dhe lartësinë e kornizave, trashësinë e mureve dhe ritmin arkitektonik. Në këtë mënyrë, çdo element i ri do të jetë i personalizuar për secilin rast, duke garantuar jo vetëm funksionalitet dhe estetikë, por edhe përputhshmëri të plotë me identitetin historik dhe përmasat e ndërtesave ekzistuese.




Fig. 19.



FOCUS ARCHITECTURE

adresa: Rr. "Brigada VIII" TIRANE
e-mail: f.architecture@yahoo.com
mob. 1: +355 69 4006658
mob. 2: +355 68 2093714

Projekti: Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të Qytetit të Vlorës.